



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

**Departamenti i Fizikës** në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për **2(dy)** pozicion pune, personel akademik, me kohë të plotë me afat të përcaktuar, të kategorisë *asistent lektor*,

**Kandidatët duhet të zotërojnë këto kritere të përgjithshme e të veçanta:**

- Të ketë përfunduar studimet universitare, Ba dhe Master i shkencave ose ekuivalente me të, në fushën e Shkencave fizike. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
- Të ketë përfunduar studimet Ba dhe Master i shkencave ose ekuivalente me të, në fushën e kërkuar me notë mesatare mbi 8.
- Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
- Preferohet të ketë publikime, trajnime si edhe pjesëmarrje në konferenca shkencore të lidhura me profilin.
- Preferohet të ketë përvojë në mësimdhënie në IAL.
- Preferohet të ketë vlerësime nga titullarë.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**28.03.2022– 06.04.2022**) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Minsitria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Çertifikata, kualifikime, brenda dhe jashtë vendit, të njehsuara me origjinalin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore

Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (28.03.2022– 06.04.2022) nga data e shpalljes në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,**

**Aplikim për pozicionin e punës:**

*Asistent lektor – Departamenti i Fizikës*

**Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Fakultetit të Shkencave të Natyrës**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (08.04.2022– 22.04.2022). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.

**Shënim:** *Formularët për plotësim gjenden në adresën:*

[www.uniel.edu.al/zona-akademike/dokumentacion](http://www.uniel.edu.al/zona-akademike/dokumentacion)